



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:282957
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06336103

Ac.nr.3393/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit Halide Reka dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson A.Th., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së 13-të, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2753/21, të datës 30.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.10.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2753/21, i datës 30.03.2023, **vërtetohet**.

II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2753/21, të datës 30.03.2023, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2753/21, të datës 30.03.2023, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.K. nga Prizreni. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën MPB - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, që paditësit, në emër të kompensimit të një page mujore (pagesës së trembëdhjetë) t’ia paguaj shumën nga 613.05 euro (gjashtëqind e trembëdhjetë euro e pesë cent), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumë të përgjithshme prej 1,839.15 (njëmijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë euro e pesëmbëdhjetë cent), e me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë 16.12.2021, e deri në përmbushjen definitive të gjitha këto afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën tre, ka refuzuar

pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të “Obligohet e paditura MPB - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, që në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 664 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1,660.00 € (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare”, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, të ndryshoj aktgjykimin C.nr.2753/21 të datës 30.03.2023, dhe të refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 16.12.2021, ka ushtuar padi kundër të paditurës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, shujtave si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar paditën e paditësit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2753/21, të datës 30.03.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit i datës 16.04.2021, i cili vërtetim gjendet i bashkangjitur shkresave të lëndës dhe është i lëshuar nga e paditura për paditësin, nga i cili vërtetim gjykata konstatoi se paditësi tek e paditura realizon pagë mujore në shumë prej 613.05€, për këto arsye gjykata ka vendosur që pjesërisht të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësit t’ia kompensojë shumën e përshkruara si në pikën I dhe I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimit duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 452, paragrafi 1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Po ashtu, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca e paditësit në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon dhe lartësia e pagës bazë të tij.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076, si dhe nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29, par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nen shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditës është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore në emër të pagës së 13-të, në shumën prej 1,839.15 €, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të performancës, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas Gjykatës së Apelit, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personeli i policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ me numër 02/2018, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është

sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit duke vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën III të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik andaj, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3393/23, me datë 22.10.2024

Kryetarja e Kolegjit-Gjyqtarja
Naime Ahmeti